



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Fjalimi i Guvernatorit

28 shkurt 2024

Ngjarja: BP6 drejt Zonës së Vetme të Pagesave të Bashkimit Evropian (SEPA)
Organizatori: Banka e Shqipërisë
Koha dhe vendi: 28 shkurt 2024, Banka e Shqipërisë, Tiranë

I nderuari z. Mete, Ministër i Financave i Shqipërisë

I nderuari z. Sejko, Guvernator i Bankës Qendrore të Shqipërisë

Ministra të Financave të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor,

Guvernatorë të Bankave Qendrore të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor,

Përfaqësues të Bankës Botërore,

Zonja dhe zotërinj,

Dëshiroj ta falënderoj Bankën e Shqipërisë për organizimin e këtij ministeriali rajonal “Gjashtë Vendet e Ballkanit Perëndimor drejt SEPA” në kuadër të Samitit Rajonal për Planin e Rritjes dhe Konvergjencës dhe për ftesën drejtuar Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të cilën ne e kemi pranuar pozitivisht.

Kam kënaqësinë të jem këtu në një ngjarje të tillë duke pasur mundësinë që t’i ndajë aktivitetet tona aktuale drejt SEPA.

Po jetojmë në një kohë kur të gjitha aspektet e jetëve tona janë duke përparuar me një ritëm aq të shpejtë të zhvillimit teknologjik dhe industria financiare është duke përparuar me të njëjtin ritëm.

Në dinamikat e zhvillimit global, sistemi financiar në Kosovë po përballet me ndryshim të shpejtë në fushën e inovacionit dhe migracionit drejt pagesave digjitale.

Një sistem i zhvilluar i pagesave financiare, ku pagesat bëhen me kosto dhe kohë efektive, e bën tregtinë më të lirë, i mundëson bizneseve konkurrese të rriten dhe u ofron konsumatorëve qasje më të lehtë në mallra dhe shërbime. Në të njëjtën kohë, sistemi i zhvilluar i pagesave siguron mbrojtjen e integritetit të sistemit financiar dhe valutës në euro, zvogëlimin e efekteve negative të

fenomenit të falsifikimit, mbrojtjen e konsumatorëve dhe promovimin e praktikave të tregut, zvogëlimin e efekteve të aktiviteteve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përmirësimin e qasjes në shërbime financiare dhe gjithëpërfshirje financiare.

Në harmoni me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe Procesin e Berlinit, procesi i reformës dhe zhvillimi i sistemit të pagesave nëpërmjet zhvillimit të pagesave të shpejta lokale dhe integrimi i sistemit të pagesave në nivel rajonal do ta përshpejtojë qasjen në SEPA.

BQK-ja ka planifikuar në Planin Strategjik 2024-2028 disa aktivitete të rëndësishme të cilat ndërlidhen me BQK-në dhe industrinë financiare, të cilat janë në harmoni me zhvillimet aktuale në fushën e digjitalizimit.

Në kuadër të aktiviteteve të BQK-së që duhet të miratohen drejt digjitalizimit, si aktivitete kryesore planifikohen këto në vijim:

- Avancimi i sigurisë kibernetike, gatishmëria e shtuar për rreziqet e sigurisë kibernetike dhe krijimi i kapaciteteve më të mëdha për ruajtjen e informacionit virtual;
- Digjitalizimi dhe automatizimi i operacioneve, mbështetjes për nënshkrime elektronike dhe proceset e autorizimit të brendshëm; dhe
- Avancimi dhe konsolidimi i evidencave të brendshme të BQK-së, si dhe ndërfaqja me sistemet e institucioneve për shkëmbimin e të dhënave në interesin më të mirë të publikut.

BQK-ja, në kuadër të mandatit të saj si autoritet për licencim, rregullim dhe mbikëqyrje të institucioneve financiare, ka planifikuar aktivitetet në vijim:

- Fuqizimi i mbikëqyrjes së sistemeve dhe instrumenteve të pagesave me rendësi sistematike, përfshirë FinTech;
- Avancimi i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse për LPP/LFT dhe përputhjen;
- Zhvillimi i infrastrukturës, rritja e sigurisë dhe efikasitetit për kliringun e pagesave dhe letrave me vlerë, menaxhimin e kolateralit dhe ndërfaqjen e sistemit;
- Avancimi i kornizës ligjore dhe rregullative në lidhje me shërbimet e pagesave, me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, PITF dhe standardet tjera ndërkombëtare;
- Zhvillimi i infrastrukturës teknike për t'i lehtësuar pagesat e shpejta 24/7, krijimi i kodit kombëtar QR dhe standardizimi i API për ndërlidhjet në sistem;
- Avancimi i kornizës rregullative për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Luftën kundër Financimit të Terrorizmit në lidhje me shërbimet e pagesave;
- Lehtësimi i qasjes në Platformat e Pagesave Ndërkombëtare;
- Zvogëlimi i pagesave në para të gatshme dhe promovimi i pagesave elektronike;
- Krijimi i mundësive për qasje në sistemin e pagesave për ofruesit e shërbimeve jobankare, si dhe mundësimi i posedimit të IBAN për rritjen e qasjes në financa në kuadër të konceptit të “llogarisë së pagesave”; dhe
- Avancimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike të BQK-së për anëtarësim në Skemën e Pagesave SEPA dhe qasje në Shlyerjen e Pagesave të Synuara “Instant” të Bashkimit Evropian (TIPS).

Aktivitetet e planifikuara të BQK-së në këtë drejtim përfshijnë:

- Kemi marrë pjesë në takime të nivelit të lartë në Bankën Qendrore Evropiane (ECB) në Frankfurt, ku ECB, në kuadër të mbështetjes së projektit të BE-së për modernizimin e sistemeve të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe objektivat e G20, është duke mbështetur iniciativa konkrete, si ndërlidhjen e sistemeve të pagesave dhe integrimin e rajonit tonë në sistemet e Bashkimit Evropian dhe jemi në kontakt të vazhdueshëm për zhvillime të mëtejshme.
- Në muajin janar të vitit 2024 kemi rifilluar prapë Këshillin Kombëtar të Pagesave për t'i mbështetur reformat në pagesa nëpërmjet përfshirjes dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në sistemin e pagesave në Republikën e Kosovës; dhe
- Kemi përcaktuar planin kombëtar për përfshirje financiare dhe zvogëlimin e përdorimit të parave të gatshme, ku do të përcaktohen e aktivitetet e palëve të interesuara dhe jemi pajtuar për rritje të qasjes, përdorim të llogarive të pagesave dhe instrumenteve të pagesave elektronike dhe zvogëlim të parave të gatshme, në mënyrë që t'i zvogëloj kostot e shërbimeve të pagesave për rrjedhën më efikase të transaksioneve, si dhe efekte tjera pozitive në ekonomi.
- Kemi krijuar mundësinë për qasje në sistemin e pagesave të institucioneve financiare jobankare, si dhe mundësinë për të pasur IBAN, për rritje të qasjes në financa, brenda konceptit të “llogarisë së pagesës,” gjithashtu kemi aprovuar rregulloren relevante.
- Kemi ndryshuar Strukturën Organizative, ku përgjegjësia për mbikëqyrjen e Institucioneve të Pagesave dhe Institucioneve të Pagesave Elektronike i është shtuar Divizionit për Mbikëqyrjen e IMF/IFJB është krijuar Divizioni për Mbikëqyrjen e Sistemeve të TI-së, në kuadër të Divizionit të Regjistrimit të Kredive, përgjegjësi e Regjistrimit të Llogarive Bankare, si dhe është krijuar Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, ku përveç Divizionit të Ankesave të Shfrytëzuesve të Shërbimeve Financiare, u krijua edhe Divizioni për Mbikëqyrjen e Praktikave të Tregut.
- Jemi në proces të finalizimit të projektligjit për Shërbimet e Pagesave, në përputhje me Direktivat e BE-së si PSD2 (Direktiva e Shërbimeve të Pagesave 2), EMD (Direktiva për Paranë Elektronike), PAD (Direktiva e Llogarisë së Pagesave) dhe tarifave të këmbimit, ku në fillim të muajit shkurt kemi organizuar bashkë me Bankën Botërore dhe Institucionet Financiare seminarin dyditor me qëllim rritjen e njohurive mbi shërbimet e pagesave bazuar në zhvillimet më të avancuara në këtë fushë.
- Gjithashtu do të rishikohet ligji kundër pastrimit të parave dhe do të ndryshohen rregulloret relevante të BQK-së për t'i përmbushur kriteret e nevojshme në këtë fushë
- Jemi në proces të ngritjes së kapaciteteve infrastrukturore dhe burimeve njerëzore për të siguruar që sistemet, pajisjet, njohuritë, aftësitë dhe mjetet e personelit të mbeten relevante dhe efektive në mbikëqyrjen e rrezeve të teknologjive të reja dhe modeleve novatore të biznesit.

- Kemi miratuar rregulloren për operacionet në para të gatshme si një nga kriteret bazë për anëtarësimin në Skemën e Pagesave SEPA dhe qasje në Sistemin e Pagesave të Shpejta të Bashkimit Evropian (TIPS).
- Kohët e fundit jemi në kontakt me Bankën Qendrore të Italisë (Banca d'Italia) dhe jemi të interesuar të mbledhim njohuri mbi statusin aktual të projektit të klonit TIPS, veçoritë e tij, zbatimin e mundshëm në kontekstin tonë të brendshëm dhe, ndoshta, kostot e lidhura.

Gjithashtu jemi duke punuar për ndërgjegjësim më të madh në institucionin tonë dhe tek institucionet e mbikëqyrura për rreziqet që lidhen me digjitalizimin.

Ndërhyrjet kibernetike paraqesin rrezik për stabilitetin e sistemeve financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për shkak të efekteve të tyre të mundshme të përhapjes ndërkufitare dhe po bëhen më komplekse si rezultat i rritjes së digjitalizimit, rritjes së varësisë nga palët e treta dhe tensioneve gjeopolitike. Prandaj, forcimi i sigurisë kibernetike në sektorin financiar është një prioritet i lartë, veçanërisht për institucionet financiare dhe për stabilitetin financiar të vendit.

Gjatë konferencave dhe punëtorive të organizuara, BQK-ja gjithashtu ka inkurajuar të gjitha institucionet financiare që të kenë struktura efektive qeverisëse dhe procese të menaxhimit të rrezikut, praktika dhe procese të menaxhimit të rrezikut në lidhje me shërbimet e jashtëkontraktuara dhe të kenë personel të kualifikuar për t'i monitoruar dhe mbikëqyrur aktivitetet e tyre të jashtme, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut operacional, monitorimin e vazhdueshëm dhe ekzekutimin e duhur të kontratave me ofruesit e jashtëkontraktuar të shërbimeve që përcaktojnë përgjegjësitë e secilës palë, nivelet e dakorduara të shërbimit dhe të drejtat e auditimit.

Do të doja ta shfrytëzoj rastin t'i falënderoj partnerët tanë ndërkombëtarë, si FMN-në dhe Bankën Botërore, për bashkëpunimin dhe koordinimin e tyre, veçanërisht Bankën Botërore e cila na ka mbështetur vitet e fundit përmes Programit të Pagesave dhe Remitancave të financuar nga SECO dhe Projektit të Modernizimit të Sistemit të Pagesave të Ballkanit Perëndimor, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i administruar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC).

Më lejoni të përfundoj duke ritheksuar se zhvillimi i sistemit kombëtar të pagesave të Kosovës përmes mundësisë së pagesave “instant” (24/7), si dhe lidhja me sistemin TIPS, si synim i BQK-së, nëse arrihet, do të kenë ndikim të madh në ekonominë e vendit tonë, të rajonit, të diasporës, si dhe në qarkullimin e pagesave për shkëmbime komerciale me BE-në, si partneri më i madh tregtar i Republikës së Kosovës, me rëndësi për lëvizjen e lirë të kapitalit, shërbimeve dhe produkteve, duke përfshirë lëvizjen e lirë të njerëzve nga Kosova përmes liberalizimit të vizave nga 1 janari i këtij viti.